



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M

Nr. 89, Datë 07.10.2008

Për
Përcaktimin e hapave të Hetimit të Thelluar në Tregun e
Importit të Grurit dhe Prodhimit të Miellit

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.10.2008 shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Përcaktimin e hapave të kryerjes së Hetimit të Thelluar në Tregun e Importit të Grurit dhe Prodhimit të Miellit.

Baza ligjore:

Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenet 24, shkronja d, neni 26, neni 43 (pika 2) të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, si dhe neni 21, pika 4, të Rregullores “Për Funkcionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Në mbështetje të Vendimit Nr. 88, datë 02.10.2008 “Për Hapjen e Hetimit të Thelluar në Tregun e Importit të Grurit dhe Prodhimit të miellit”;

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e Fazave të kryerjes së Hetimit të Thelluar si vijon:
 - a) Inspektime në ndërmarrjet nën hetim;
 - b) Mbledhja e informacioneve të nevojshme dhe plotësuese;
 - c) Përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur;
 - d) Hartimi i Raportit të Ndërmjetëm brenda datës 31 Janar 2009;
 - e) Diskutim i Raportit të Ndërmjetëm me Komisionin;
 - f) Organizimi i Seancës Dëgjimore;
 - g) Hartimi i Raportit Përfundimtar të Hetimit të Thelluar dhe paraqitja e tij përpara Komisionit.
2. Sekretari i Përgjithshëm të miratojë Matricën e Veprimeve të Hetimit të Thelluar sipas hapave të përcaktuar më sipër në këtë vendim.
3. Afati i fundit për kryerjen e këtij hetimi është data 28.02. 2009.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(_____)
Zv/Kryetar

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R